



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-15891 dt. 14/04/2021

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Komunës së Drenasit z. Labinot Halilaj, me dt: 21.04.2021 (E Mërkure) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:


1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 19.03.2021.
2. Raporti financiar i zhvillimit të buxhetit Janar Mars 2021
3. Raport i ndihmave dhe subvencioneve për vitin 2020
4. Propozim Vendim për bartjen të hyrave vetanake nga viti 2020, në vitin 2021.
5. Të ndryshme.

Drenas, 14. 04 .2021



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



12 Nr. 060/04-15893 dt. 14/04/2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 19.03.2021, ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,, Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku, Drejtori I Drejtoris për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Arsim Haxhiu .

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 19.02.2021.
2. Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare „Dr. Hafir Shala” Drenas (Glllogoc)
3. Draft-Raport i tretë periodik për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
4. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e katër fushave sportive në zonat kadastrave Korroticë e Poshtme, Terstenik, Dobroshec dhe Llapushnik.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF-ca, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës, fjalën ja jep kryetarit **Ramiz Lladrovci**.

Fjalën e merr Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci - Kisha kërkuar heqjen e pikës së katërt për shkak se parcelat të cilat na nevojiten për ndërtimin e katër fushave sportive , na duhet edhe pak kohë për arsye se i kemi shkruar agjencionit të pyjeve më na e lejua hapësirat ose pronat që janë në emër të tyre. Komuna për fat të keq ka prona që ne i konsiderojmë që janë të komunës por në data bazë të tyre ose në sistem të tyre figurojnë si prona të Agjencisë së Pyjeve. Kisha thënë që me tërheqë që mos me hyrë dy fusha me i gjete sot e dy në mbledhjen tjetër me e shty mbledhjen tjetër deri ta marrim përgjigjen se brenda 30 ditëve janë të obliguar agjencioni me na e kthye

përgjigje dhe besoj që në mbledhjen tjetër të kemi përgjigjen që ne të mos ndërtojmë sikur kanë ndërtuar përpara.

Burim Bujupi – Para se me tërheqë kisha deshtë me e pyet kryetarin. A ju keni drejtuar më shkresë zyrtare Agjencionit të Pyjeve.

Fjalën e merr Kryetarin të Komunës Ramiz Lladrovci- Ne ju kemi drejtuar njëherë kadastrit disa herë. Ne ju kemi drejtuar për parcela specifike që janë në emër të agjencionit , ju kemi drejtuar atyre pasi i kemi shterur të gjitha opsionet.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hedhi ne votim rendin e ditës me pikën e tërhequr me kërkesën e kryetarit ,rendni i ditës kalojë në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj -hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KPF-ca dt. 22 .01.2021.

Diskutime nuk pati ,edhe kjo pike u votua në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj -kalojmë të pika e dytë: Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare „Dr. Hafir Shala” Drenas (Glllogoc).

Fjalën e merr Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Arsim Haxhiu – Siç jeni në dijeni nga viti i kaluar ne patëm aprovuar atë statutin më herët. Kemi pasur në ndërkohe një kthim mbrapa të ministrisë për shkak që kanë qenë të propozuara disa variante të mundshme siç ka qene rasti i prezencës së radiologëve aty ku i kanë QKMF-të , ju kujtohet kur e kemi kthyer edhe një herë në kuvend , ka qenë pandemia vitin e kaluar. Megjithatë pas daljes së udhëzimit administrativ 04/2020 d.m.th. janë aprovuar këto vërejte të gjitha dhe kemi parë të arsyeshme që të dilet më formën unike të statutit, në bazë të udhëzimit 04/2020 , ku janë përcaktuar veprimtaritë edhe shërbimet e kujdesit parësorë shëndetësorë si dhe struktura organizative dhe kemi parë të arsyeshme të nxirret forma unike e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare „Dr. Hafir Shala” në Drenas. Dy, tri ndryshime janë bërë, një është aprovimi se kujdesi parësorë shëndetësorë në komuna ku ka mbi njëqind (100) të punësuar duhet të këtë edhe zëvendës drejtorin , e dyta është që pjesa e radiologjisë ku ka radiolog QKMF-të të jenë pjesë përbërëse faktikisht deri në pension , për shkak se kujdesi parësorë lëmit tjera siç e dini përveç mjekësisë familjare nuk i ka në kuadër të veprimtarisë së vet dhe ndryshimi tjetër është që qendrat e mjekësisë familjare të cilat kanë qenë e të cilat nuk i kanë dhjetë mijë banorë (10 mijë) shndërrohen në tipin e ambulancave familjare. Këto janë tri ndryshimet kryesore të cilat udhëzimi administrativ 04/2020 i parasheh dhe në bazë së cilave kemi plotësuar dhe kemi bërë statutin e ri. Është në harmoni me udhëzimin 04/2020. D.m.th. ky është udhëzimi administrativ që është nënshkruar diku nëse nuk gaboju më 20 nëntor 2020 ndërsa më 27 nëntor 2020 ka hyrë në fuqi , d.m.th në vitin që e lamë pas. Mirëpo për shkak të veprimtarisë specifike na duhet që ta qesim në kuvend ta aprovojmë dhe natyrisht Ministria e Shëndetësisë na jep formën. Është nënshkruar më 20 nëntor 2020 ndërsa më 27 nëntor 2020 ka hyrë në fuqi. Është forme unike për të gjithë Kosovën

Burim Bujupi – Në bazë të udhëzimit administrativ duhet me e pas edhe një zëvendës drejtor qe nuk e kemi pasur deri më tani edhe këto qendrat e frekuentuara që janë , qendrat familjare , a vlejné për krejt që e frekuentojné p.sh po supozojë në Arllat për numrin e banorëve mes Llapushnikut , Arllatit, Negrocit Lagjës së Bytyqve komplet.

Fjalën e merr Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Arsim Haxhiu- Shiko ne pak prej aspektit praktik dhe udhëzimit administrativ edhe statutit kemi vetëm dy qendra të mjekësisë familjare Drenasi dhe Komorani , ndahen në dy qendra të mjekësisë familjare ndërsa gjitha ambulancat tjera ku gravitojnë aty , natyrisht raporti është një mjek më dy mijë banorë (2 mijë) gjithmonë. Ka ambulante qe mundet me i ra edhe dy

mjek edhe tre mjek varësisht prej numrit të banorëve , por ato qendra kur nuk i kanë dhjete mijë banor (10 mijë) do të thotë që nuk mund të jenë më qendra të mjekësisë familjare për shkak të strukturës, angazhimit të madh dhe pamundësisë. E kemi edhe regjistrimin e popullatës që është bërë në vitin 2011, çdo fshat ka sa banorë i ka. Ato qe gravitojnë me një qendër deri në dhjete mijë banorë (10 mijë).

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj hodhi në votim pikën e dytë. Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare „Dr. Hafir Shala” Drenas (Glllogoc), dhe kjo pike u votua ne mënyre unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj -hapi diskutimin për pikën e tretë: Draft-Raport i tretë periodik për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Fjalën e merr **Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku** – Ky është raporti i tretë që e kanë bërë komisioni për implementimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. I kemi pasur gjithsejtë katërmëdhjetë (14) rekomandime , ku në rekomandimin e parë kemi pasur kryesisht më vendime gjyqësore për paga përcjellëse dhe paga jubilarë i cili rekomandim nuk është në domenin e mundësive të kuvendeve komunale që ti realizojnë këto sepse këto behën ekzekutime nga thesari , ndërsa kemi pasur edhe një rekomandim këtu lidhur më shpenzimet e varrimit të cilit ne i kemi pasur në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbimeve. Në planin kontabël të Republikës së Kosovës këto shpenzime parashihen , e kanë kodin e veçantë mallra-shërbime , mirëpo Zyra Kombëtare e Auditimit ka kërkuar që ne këto shpenzime ti fusim ne subvencione dhe i kemi futur , janë futur për vitin 2021 dhe ky rekomandim është plotësisht i implentuar . Nga rekrutimi i stafit mundem të them se edhe ky është i plotësuar d.m.th nuk ekziston më si rekomandim. Rekomandimi i tretë ka të bëjë më çerdhet, gjegjësisht kërkesat për blerje të cilët janë shkuar më tre tenderë për shkak të mundësisë së buxhetit , vonimi i buxhetit viteve 2020 , aprovimi i tij ka ndikuar që të shkojmë më tre tenderë për furnizim me ushqim për fëmijët ne çerdhet komunale . Rekomandimi i katërt, hartimi i projekteve ekzekutive ,është zbatuar pjesërisht , sepse ky rekomandim ka implikime bukur të mëdha se secili projekt duhet bërë projekti detal dhe me stafin që e kemi ne dhe mundësitë teknike është e pamundur që ne të mbërrijmë që ti hartojmë të gjitha por kuvendi komunal në vitin 2021 ka angazhuar firma për hartimin e projekteve dhe ky pjesërisht është i zbatueshëm. Një rekomandim na u ka dhëne për rrugën Vuqak- Terdevc , mirëpo ky nuk është plotësisht i zbatuar sepse ne nuk kemi pasur me implementua projektin ka pasur Ministria e Infrastrukturës i cili në vitin e kaluar nuk është zbatuar si projekt , nuk është zhvilluar ,mirëpo ana teknike e tij që varet prej kuvendit komunal është zbatuar plotësisht. Ndërtimi i kolektorëve thotë kemi bërë furnizime dhe nuk janë kryer të gjitha punët mirëpo ky është kryer , rekomandim i zbatuar. Te rekomandimi numër shtatë e kemi ndriçimin publik edhe ky është rekomandim i zbatuar. Vonesa në furnizime, kjo po varet zakonisht tek kontratat të cilat i nënshkruan niveli qendror dhe ne po kemi pengesa , por nuk është që ne po vonohemi si kuvend komunal , mirëpo po vonojnë operatorët ekonomik të cilët e kanë kontratën e nënshkruar më nivelin qendror dhe ndikimi i jonë tek ta është mjaft i vogël dhe kjo është pjesërisht i zbatuar. Shpenzimet e gjyqësisë, d.m.th këto janë pjesërisht të zbatuara sepse mund të ndodh prapë se nuk varen prej neve kryesisht janë vendime që merren nga ana e gjykatave. Kemi ndryshime në pozicionin e kontratave është i zbatuar se kemi raste kur hartimi i projektit e ka paraparë që një pozicion të këtë që kaq shumë p.sh shumë një mijë euro (1 mijë), ndërsa kur dalin në terren dhe implentimi i projektit kërkon që të behët një mijë e dyqind euro (1200) , kjo behët zakonisht , por është i zbatuar d.m.th kërkohet leja e kryetarit të komunës i cili lejon më u bërë ato ndryshime por shuma totale projektit nuk duhet të tejkalohet. Regjistrimi i pasurive; edhe ky si rekomandim është

pjesërisht i zbatuar edhe kisha pasur dëshirë që ne të mundemi të mbërrimë ti regjistrojmë të gjitha pasuritë, është problem furnizimi nga operatorët ekonomik, sidomos pajisjet po kemi vonesa në pajisje. Ne kemi pasur rastin p.sh kur viti fiskal të ne mbyllet në drejtorinë e financave me 24 dhjetor në ora 12:00. Pajisjet na vijnë më 27, 28, 29 dhjetor edhe është e pamundur më i bërë pagesat e tyre. Ky pjesërisht është i zbatuar mirëpo në tërësi është problem me u zbatuar po flasim në parametrat real. Edhe kemi mbivlerësimin e detyrimeve kapti gjente. Ne kemi zyrën ligjore në Ministrinë e Financave e cila merret më lëndët e Komunës së Drenasit po ashtu edhe të gjitha komunave dhe të komunës tonë dhe ata e kanë dhënë një obligim të Komunës dy herë se ka bërë ankesë qytetari dhe është regjistruar dy herë dhe ata na e kanë futur si mbivlerësim i detyrave ka qenë vlera diku pesë mijë e gjashtëqind euro (5600) jo vlerë më e madhe mirëpo si rekomandim gjoja se është e gjetur e tyre mirëpo edhe kjo është e zbatuar nuk kemi më raste të tilla. Mos kompletimi i njësisë së brendshme të auditimit edhe ky është pjesërisht sepse ne numrin e banorëve e kemi pesëdhjetë e tetë mijë (58 mijë), numrin e punëtorëve të tri sektorët e kemi një mijë e treqind e njëzete e pesë (1325) ky është pjesërisht i zbatuar dhe i kemi dy auditorë të brendshëm. Kjo kishte më qenë në pika të shkurtra sa i përket Draft Raportit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Burim Bujupi – Vetëm desha të lidhem te shpenzimet e varrimit ne siç e di në vitin 2018 ka qenë si rekomandim e kemi pasur bile me u kthyer në mallra shërbime pse tani paska ndryshuar, tani prej cilës kategori merren subvencionet.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku-subvencionet janë kategori e veçante e buxhetit për nga natyra e shërbimeve është mallra dhe shërbime për nga natyra e dhënies është subvencion, se po subvencionohen qytetarët dhe për këtë arsye e kemi qit në subvencione për vitin 2021 dhe është i zbatuar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj –hedh ne votim pikën e tretë: Draft-Raport i tretë periodik për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, edhe kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj kalojmë të pika 5. Të ndryshme.


Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 35 min.

Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC

01 Nr. 400-15338

Më
On. 12.04.2021



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT



RAPORTI FINANCIAR
I Zhvillimit Të Buxhetit Janar - Mars 2021

PRILL 2021

Baza për Raportim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP-së) përkatësisht neni 45.4, kryetari i komunës duhet të përgatit dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte periodike të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të vitit i cili sa po ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo periode, dhe më pasë duhet të publikohen në faqen e internetit të komunës.

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftoi Bordin e Drejtorve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal, të gjitha mediet (elektronike dhe të shkruara) si dhe qytetarët për realizimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese janar-Mars 2021. Buxheti komunal për periudhën janar-Mars 2021 nënkupton Ligjin .07/L-041 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Deri sa buxheti paraqet qëllimet e performancës, raporti paraqet masën deri në të cilën qëllimet e performancës janë arritë, duke përfshirë vlerësimin kuantitativ dhe kualitativ të rezultatëve. Ky raport gjithashtu paraqet edhe krahasime me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Në këtë raport paraqitet mënyra e realizimit të buxhetit për nga karakteri ekonomik në pesë kategori kryesore ekonomike të shpënzimit; ndërsa për nga karakteri funksional në njëzetë (20) programe -nënprograme buxhetore.

Të dhënat e raportit për shpenzimet operative (Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime të Shërbimeve Komonale dhe Subvencio) dhe Shpenzime të Investimeve Kapitale, janë në harmoni me Departamentin e Thesarit pranë Ministrisë për Financa, ndërsa të dhënat për numrin e punëtorve dhe shumat për shpenzimet e Pagave dhe Mëditjeve me Shërbimin e përllogaritjes së pagave Ministrin e Administratës Publike.

Përgatitja e raportit është bërë në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-048, të ndryshuar me Ligjin 04/L-221, dhe Standardet Ndërkombtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) bazuar në para të gatshme-raportimi financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Zyra e Kryetarit gjatë përgatitjes së këtij raporti s' bashku me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa është munduar me përkushtimin më të madh që me detaje dhe saktësi të paraqes realizimin-zhvillimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese, gjegjësisht janar-Mars/021. Valuta raportuese është Euro (€).

Ne mirëpresim çdo koment që do të kontribonte pozitivisht në përmirësimin e raporteve të ardhshme.

Tabela Nr.1 Buxheti Komunal të rishikuar sipas Ligjit Nr.07/L-041 për Buxhetin e Republikës së Kosovës /2021, shprehur në euro.

Tab.nr.1

Përshkrimi	Buxheti	Pagat	Mallra e sherb.	Shpenz.Kom.	Subv.e transf.	In.Kapitale	Nr i puntorve
Z.Kryetarit	292,170.00	156,956.00	129,214.00	-	6,000.00	-	19
Adm.person	537,155.00	235,055.00	139,100.00			163,000.00	42
Inspektorati	109,844.00	72,329.00	37,515.00				11
Z.Kuvendit	147,965.00	109,465.00	38,500.00				
Buxhet dhe finan.	122,265.00	103,865.00	18,400.00				16
Shërb Pub. Em.	781,959.00	173,363.00	282,596.00	90,000.00	90,000.00	146,000.00	25
Infrastruktur Publ	2,409,140.00	47,801.00	25,750.00			2,335,589.00	8
Z.K.Kthim	8,673.00	7,983.00	690.00				1
Bujqësia	128,957.00	73,217.00	11,740.00		44,000.00		13
Planif.dhe Zhvill.E	94,539.00	48,789.00	25,750.00		20,000.00		8
Gjeodezi dhe Kad.	493,990.00	83,440.00	10,550.00			400,000.00	13
Urbanizmi	106,796.00	48,379.00	18,417.00			40,000.00	8
Administrata Sh.	114,175.00	36,837.00	52,338.00		25,000.00		5
Kujd.Prim.Shënd	2,084,614.00	1,300,143.00	352,614.00	48,000.00		383,857.00	181
Shërb Sociale	115,043.00	92,379.00	16,713.00	5,951.00			14
Kultura dhe sporti	475,767.00	76,318.00	49,449.00		105,000.00	245,000.00	13
Adm. Arsım	866,478.00	76,212.00	315,266.00		80,000.00	395,000.00	12
Ars.Parafillor	171,217.00	118,615.00	46,482.00	6,120.00			22
Ars. Fillor	4,931,473.00	4,548,372.00	321,789.00	61,312.00			739
Ars. I Mesem	1,407,114.00	1,290,482.00	95,507.00	21,125.00			175
	15,399,334.00	8,700,000.00	1,988,380.00	232,508.00	370,000.00	4,108,446.00	1,325

Deri sa tabela e lartë shënuar paraqet buxhetin-planifikimin e të hyrave dhe të dalave-shpenzimeve, tabelat në vazhdim të raportit paraqesin zhvillimin e buxhetit, po ashtu për të hyra dhe të dala për periudhën raportuese.

Realizimi i të hyrëve vetanake për periudhën Janar - Mars 2021 dhe krahasimi i tyre me një vit më parë.


Tabela nr.2

Nr.rend	Muaji	Plani 2021	Realizimi 2021	Real.Vitit 2020	% me plan	Krahasimi me 2020%
1	Janar	108,888.33	108,195.73	98,915.00	99.36	109.38
2	Shkurt	108,888.33	70,062.74	102,622.35	64.34	68.27
3	Mars	108,888.33	87,324.29	48,700.69	80.20	179.31
	Totali	326,664.99	265,582.76	250,238.04	81.30	106.13

Vërejtje :Shenime nga raporti i free balance të datës 02.04.2021 pa gjoba trafiku dhe gjykatav.

Tabela Nr.2, paraqet të dhënat lidhur me arkëtimin e të hyrave nga burimet vetanake për periudhën janar- Mars të vitit fiskal 2021, të krahasuara me periudhën e njëjt të vitit paraprak. Krahasuar me planifikimin (1,306,660.00 €) të hyrat nga burimet vetanake janë realizuar 20.33 % , ndërsa në raport me periudhën e njëjt të një vitit më parë kemi ngritje të performancës për 6.13%, ne këtë raport nuk janë paraqitur të hyrat indirekte nga gjykatat dhe gjobat e komunikacionit dhe grantet e performancës .

Paraqitja grafike e planifikimit të të hyrave dhe realizimit për periudhën Janar - Mars të vitit 2021.



Pasi që më lartë është bërë shpalosja e të hyrave vetanake të planifikuara e të realizuara, duke u krahasuar me vitin paraprak, kurë është fjala të Grantet Qeveritare planifikimi vjetor është i paraparë të jetë në shumë prej: 14,092,674.00€, nga kjo del periudha raportuese do të jetë në shumë prej:3,523,168.50 €, ndërsa me buxhet paraqitet shuma prej:5,872,942.65 €,

Të dhënat e raportit të Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar tregojnë se ndarjet nga Grantet janar-Mars paraqesin shumën prej: 5,872,942.65 €, krahasuar me planifikimin kemi ndarje sipas planifikimit,kemi ndarje më shumë për shumën e kerkuar sipas kesh planit

Shikuar ndarjet Alokimet) e Granteve (14,092,674.00 €) për nga karakteri i shpenzimeve, shpenzimet operative (P&M, M&Sh,Sh.Sh.K) marrin pjesë në shumë prej :2,921,044.39 €, apo 47.99 %; kurse Sh.Kapitale me shumën prej:2,881,998.25 €, apo 47.35 %,Subvencionet me 1.42% Në periudhën janar-Mars/021, (Alokimi) pranimet-të hyrat për nga burimet e financimit janë realizuar si vijon:

- * Grantet Qeveritare (Burimi i financimit 10) = 5,872,942.65 €,
- *Të Hyrat nga Burimet Vetanake 2021 (Burimi i financimit 21) = 208,258.47 €, të alokuara
- *Të Hyrat nga Burimet Vetanake 2020 (Burimi i financimit 22) = 0.00 €, dhe
- *Donacionet (Burimi i financimit 31) =2,213.25 €.
- * Grande për performanc (59-61) =3,242.51 €

Gjithsejt pranimet	6,086,656.88
---------------------------	---------------------

Zhvillimi i buxhetit komunal për periudhën Janar-Mars 2021 lidhur me të dalat-shpenzimet

Dihet se komuna shpenzimet i menaxhon përmes llogarisë së vetme të Thesarit (LVTH) e cila mbulohet nga Autoriteti Bankar I Kosovës (AQBK) më këtë Nr.1000650070000022.

Procesi i shpenzimeve është i përfshirë në disa koncepte kryesore (Ndarje teknike) lidhur me shpenzimin e parave publike, së pari kemi të bëjmë me delegimin e përgjegjësisë nga Zyrtari Kryesor Administrativ të menaxherët e programev-nënprogrameve, njëherit mbajtës të buxheteve, procesë ky si çdo vit edhe në këtë, është bërë në janar/021 nga ana e Kryetarit të Komunës, proces i cili ngrit transparencën dhe performancën, krahas përgjegjësisë. Në vijim kemi edhe këto ndarje teknike - koncepte kryesore:

- * Ndarja buxhetore ,
- * Akordimi i fondeve ,
- * Zotimi i fondeve ,
- * Inicimi i shpenzimeve ,
- * Prokurimi,
- * Pranimi i mallërave - shërbimeve ,
- * Pagesa e faturave dhe
- * Lëshimi i fondeve nga llogarija bankare.

Për të arritur qëllimet e një performance sa më të mirë në drejtim të shfrytëzimit të parasë publike (Vlera për parane) me kohë në janar të këtij viti është përgatitur Plani i zotimit dhe shpenzimit të parasë së gatshme sipas periodave të vitit 2021 dhe është dorëzuar në Departamentin e Thesarit-M.F si para kushtë i ndarjes së mjeteve. Për këtë periudhë mjetet financiare janë akorduar sipas planit , Pagat dhe Mëditjet një e dymbdhjeta e buxhetit për muaj; ndërsa për kategorit tjera ekonomike të shpenzimeve sipas planit.

Në tabelat vijuese është bërë paraqitja e zhvillimit të buxhetit si për nga karakteri ekonomik, e poashtu edhe funksional i planifikimit dhe shpenzimit.

Realizimi - shpenzimi i buxhetit komunal sipas Programëve-nënprogrameve për periudhën Janar -Mars 2021

Zyra e Kryetarit

Tab.3							
Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet 21	Shpenzimi 2020	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Mëditjet	26,799.68	26,799.68	27,583.20	100.00	17.07	156,956.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	24,000.00	11,069.41	22,259.00	46.12	8.57	129,214.00
3	Subvencione dhe transf.	2,000.00	1,500.00	-	75.00	25.00	6,000.00
4	Investime Kapitale	-	-	-	-	-	-
Totali		52,799.68	39,369.09	49,842.20	74.56	13.47	292,170.00

Administrata dhe Personeli

Tab.4							
Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Mëditjet	47,662.62	47,662.62	52,214.01	100.00	20.28	235,055.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	34,776.00	19,878.11	33,614.84	57.16	14.29	139,100.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	206.77	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	71,500.00	-	-	-	-	163,000.00
Totali		153,938.62	67,540.73	86,035.62	43.88	10.91	537,155.00

Drjetorati i Inspekcionit

Tab.5							
Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet 21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Mëditjet	17,177.73	17,177.73	15,966.72	100.00	23.75	72,329.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	9,500.00	5,160.30	1,688.00	54.32	13.76	37,515.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		26,677.73	22,338.03	17,654.72	83.73	20.34	109,844.00

Zyra e Kuvendit Komunal

Tab.6							
Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Mëditjet	28,560.01	28,560.01	27,675.77	100.00	26.09	109,465.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	6,810.00	1,154.90	1,475.47	16.96	3.00	38,500.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		35,370.01	29,714.91	29,151.24	84.01	20.08	147,965.00

D.për Buxhet dhe Financa

Tab.7							
Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me Alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Mëditjet	21,654.98	21,654.98	23,135.24	100.00	20.85	103,865.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	1,500.00	407.34	434.92	27.16	2.21	18,400.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		23,154.98	22,062.32	23,570.16	95.28	18.04	122,265.00

Sherbimet Publike Emergjente

Tab.8							
Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet 21	Shpenzimi 20	% me Alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Mëditjet	42,591.27	42,591.27	55,852.23	100.00	100.00	202,936.60
2	Mallrat dhe Sherbimet	152,000.00	28,172.32	50,359.66	18.53	18.53	251,364.84
3	Shpezimet Komunale	25,000.00	22,847.01	14,889.11	91.39	91.39	85,495.00
4	Subvencione dhe transf.	30,000.00	7,070.00	-	23.57	23.57	8,657.63
5	Investime Kapitale	45,000.00	994.00	-	2.21	2.21	177,332.71
Totali		294,591.27	101,674.60	121,101.00	34.51	34.51	725,786.78

D. Infrastruktura Publike

Tab.9							
Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me Alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Mëditjet	10,260.66	10,260.66	31,709.21	100.00	100.00	40,406.39
2	Mallrat dhe Sherbimet	6,500.00	2,136.43	20,257.42	32.87	32.87	13,403.94
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	1,724,088.24	89,937.75	2,946,297.15	5.22	5.22	4,822,154.66
Totali		1,740,848.90	102,334.84	2,998,263.78	5.88	5.88	4,875,964.99

Zyra për Komunitete dhe Kthim

Tab.10

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me Alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	1,980.12	1,980.12	-	100.00	-	7,983.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	270.00	84.80	-	31.41	12.29	690.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		2,250.12	2,064.92	-	91.77	23.81	8,673.00

D.e Bujqësisë

Tab.11

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	16,223.72	16,223.72	16,840.95	100.00	22.16	73,217.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	2,180.00	1,913.71	3,021.02	87.78	16.30	11,740.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	25,614.24	1,466.83	-	-	3.33	44,000.00
5	Investime Kapitale	2,213.25	-	-	-	-	-
Totali		46,231.21	19,604.26	19,861.97	42.40	15.20	128,957.00

D.për Planifikim dhe zhvillim Ekonomik

Tab.12

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me Alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	9,493.56	9,493.56	9,911.40	100.00	19.46	48,789.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	6,943.00	870.43	5,678.01	12.54	3.38	25,750.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	20,000.00
Totali		16,436.56	10,363.99	15,589.41	63.05	10.96	94,539.00

D.Sherbimeve Kadastrale

Tab.13

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet 21	Shpenzimi 20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	14,186.35	14,186.35	16,767.95	100.00	100.00	83,440.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	5,100.00	1,782.30	1,803.54	34.95	34.95	10,550.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	400,000.00	292,339.50	-	73.08	73.08	400,000.00
Totali		419,286.35	308,308.15	18,571.49	73.53	73.53	493,990.00

D.për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të mjedisit

Tab.14

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	7,387.11	7,387.11	8,317.41	100.00	15.27	48,379.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	4,450.00	2,290.59	2,012.60	51.47	12.44	18,417.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	25,000.00	-	-	-	-	40,000.00
Totali		36,837.11	9,677.70	10,330.01	26.27	9.06	106,796.00

D.Administratës Shëndetësë

Tab.15

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	8,377.92	8,377.92	9,102.23	100.00	22.74	36,837.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	4,338.00	797.24	13,121.98	18.38	1.52	52,338.00
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	7,000.00	-	-	-	-	25,000.00
Totali		19,715.92	9,175.16	22,224.21	46.54	8.04	114,175.00

Sherbimet Primare Shëndetësore

Tab.16

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	394,781.76	394,781.76	311,232.71	100.00	30.36	1,300,143.00
2	Mallrat dhe Sherbimet	161,759.50	119,553.85	43,911.88	73.91	33.91	352,614.00
3	Shpezimet Komunale	12,000.00	9,942.04	12,389.50	82.85	20.71	48,000.00
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
5	Investime Kapitale	333,856.76	-	-	-	-	383,857.00
Totali		902,398.02	524,277.65	367,534.09	58.10	25.15	2,084,614.00

Sherbimet Sociale

Tab.17

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet 21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	21,472.44	21,472.44	18,781.98	100.00	27.80	77,235.57
2	Mallrat dhe Sherbimet	4,000.00	138.54	943.68	3.46	1.34	10,304.40
3	Shpezimet Komunale	1,451.00	1,128.67	1,589.77	77.79	29.81	3,786.16
4	Subvencione dhe transf.	-	-	-	-	-	-
Totali		26,923.44	22,739.65	21,315.43	84.46	24.90	91,326.13

D.për Kultur Rini dhe Sport

Tab.18

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet 21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	15,124.09	15,124.09	16,203.00	100.00	24.76	61,076.05
2	Mallrat dhe Sherbimet	12,363.00	9,017.97	40,065.81	72.94	21.98	41,033.28
3	Shpezimet Komunale	-	-	-	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	5,000.00	-	-	-	-	80,300.39
5	Investime Kapitale	30,000.00	-	-	-	-	227,045.00
Totali		62,487.09	24,142.06	56,268.81	38.64	5.90	409,454.72

D. Administratës Arsijm

Tab.19

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet 21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	38,610.72	38,610.72	17,642.36	100.00	56.91	67,839.91
2	Mallrat dhe Sherbimet	182,120.00	82,001.87	64,603.99	45.03	16.07	510,285.46
3	Shpezimet Komunale	-	-	206.77	-	-	-
4	Subvencione dhe transf.	14,000.00	14,000.00	-	100.00	14.53	96,349.90
5	Investime Kapitale	250,340.00	27,749.30	-	11.08	3.78	734,533.16
Totali		485,070.72	162,361.89	82,453.12	33.47	11.52	1,409,008.43

Arsimi Parafillor

Tab.20

Nr. Rendor	Pershkrimi	Ndarjet sipas SIMFK-së	shpenzimet 21	Shpenzimi20	% me alokim	% buxh final	Buxheti final
1	Pagat dhe Meditjet	33,538.20	33,538.20	30,702.86	100.00	27.69	121,099.10
